

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në kolegjin e përbërë prej

Maria Giuliana Civinini Gjyqtare e EULEX-it në Gjykatën Supreme dhe Kryetare e kolegjit

Charles L. Smith III Gjyqtar i EULEX-it në Gjykatën Supreme – anëtar i kolegjit

Lars Dahlstedt Gjyqtar i EULEX-it në Gjykatën Supreme – anëtar i kolegjit

Marie Ademi Gjyqtare e Gjykatës Supreme – anëtare e kolegjit

Salih Toplica Gjyqtar i Gjykatës Supreme – anëtar i kolegjit

Të ndihmuar nga Maria Rosa del Valle Lopez si procesmbajtëse në lëndën penale kundër të pandehurit:

Miroslav Vučković, me nofkën “Mosa”, emri i babait Momqilo Vučković, mbiemri i vajzërisë së nënës Borka Jevtiq, i lindur më 22 shtator 1948 në fshatin Suhadoll i epërm, Komuna e Mitrovicës, i vejë me dy djem, din shkrim dhe lexim, punësimi aktual i panjohur, ka mbaruar shkollën e lartë teknike, ka mbaruar shërbimin ushtarak në Kovin në vitin 1967, me gjendje ekonomike të panjohur.

I akuzuar për pesë (5) pika të Krimeve të luftës siç është përcaktuar me nenin 142 në lidhje me nenet 22 dhe 26 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LPRSFJ-së).

Duke vepruar lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të datës 26 mars 2010, të paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Kosovës kundër aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz Nr. 1/2009, të datës 7 tetor 2009, lëshon këtë,

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit kundër aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz Nr. 1/2009, të datës 7 tetor 2009, **PRANOHET**; aktgjykimi përmban shkelje esenciale të:

- (a) Neni 385.1 në lidhje me nenet 381.1, 372.2 dhe 373 të Kodit të Procedurës Penale të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPKRSFJ-së) kur vërteton se Ligji nuk lejon ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe nuk ofron asnjë mjet tjetër përveç kthimit të lëndës për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
- (b) Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore dhe Lirive të Njeriut (KEDNj) kur vërteton se skadimi i dhjetë (10) viteve në lidhje me një numër të rigjykimeve i mundëson gjykatës së shkallës së dytë që ta ndërpres procedurën penale dhe ta liroj të pandehurin nga të gjitha akuzat në bazë të parimit *in dubio pro reo* në mënyrë që t'i mbroj të drejtat e tij/saj themelore të njeriut.

ARSYETIM

1. *Historia e procedurës.*

Pas gjykimit të parë, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e ka dënuar të akuzuarin për veprën penale Gjenocid në bashkëpunim sipas neni 141 në lidhje me nenin 22 të LPRSFJ-së, dhe të pandehurit i ka shqiptuar katërbëdhjetë (14) vjet burgim.

Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe e ka kthyer lëndën në rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

Pas gjykimit të dytë, dyzet e katër (44) seanca – Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka shpallur të pandehurin fajtor për Krime të luftës kundër popullatës civile në bashkëpunim me të tjerët, sipas neni 142, paragrafit 1 të LPRSFJ-së, në lidhje me nenin 22 të LPRSFJ-së, dhe të akuzuarin e ka dënuar me dymbëdhjetë (12) vjet burgim.

Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe e ka kthyer lëndën në rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

Pas gjykimit të tretë, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka lëshuar aktgjykimin P. 48/01, të datës 23 maj 2008, dhe ka shpallur të pandehurin fajtorë për plaçkitje siç përcaktohet me nenin 142 në lidhje me nenet 22 dhe 26 të Kodit Penal të Jugosllavisë (KPJ-së), dhe e përcaktuar me nenin 4, paragrafin 2 (g) të

Protokollit Shtesë II të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe Aplikimin e Masave të Terrorit dhe Frikësimit, siç përcaktohet me nenin 142 në lidhje me nenet 22 dhe 25 të KPJ-së, dhe të përcaktuara me nenin 13, paragrafin 2 të Protokollit Shtesë II të Konventës së Gjenevës të vitit 1949. Ka shqiptuar një dënim unik me tetë (8) vjet burgim.

Gjykata Supreme e Kosovës, në aktgjykimin Ap-Kz Nr. 1/2009, të datës 7 tetor 2009, ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka liruar të pandehurin nga të gjitha akuzat.

Prokurori Publik ka paraqitur Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë më 31 mars 2010, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. – Kz Nr. 1/2009, të datës 7 tetor 2009.

Përfaqësuesi ligjor i të pandehurit, avokati Miro Deleviq, më 23 korrik 2010 ka paraqitur një kundërshtim ndaj Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë; në këtë kuptim, avokati Bogdan Vladisavljeviq gjithashtu duke e përfaqësuar të pandehurin më 20 shtator 2010 ka paraqitur kundërshtim ndaj Kërkesës për mbrojtjen e Ligjshmërisë

Ky Aktgjykim vendos lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur më 31 mars 2010, nga Prokurori Publik kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz Nr. 1/2009, të datës 7 tetor 2009.

2. *Arsyetim.*

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit ngit tri çështje: (1) nëse Prokurori Publik është i obliguar që ta respektoj afatin prej tre muajve të përcaktuar me nenin 452.3 të KPPK-së për të paraqitur mjetin e mbrojtjes së ligjshmërisë, (2) opsionet procedurale në shkallën e dytë kur aktgjykimi i shkallës së parë përmban vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe (3) nëse lirimi i të pandehurit është në pajtim me ligjin.

2.1. Nëse Prokurori Publik është i obliguar që ta respektoj afatin prej tre muajve të përcaktuar me nenin 452.3 të KPPK-së për të paraqitur mjetin për Mbrojtjen e Ligjshmërisë.

Neni 452 i KPPK-së përcakton se kush ka të drejtë të paraqesë kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë dhe afatin për këtë qëllim. Tre paragrafët e parë të nenit 452 merren me këtë çështje:

- **Paragrafi 1 – përcakton kushtet e përgjithshme.** Në kushte të përgjithshme përcakton se kush mund të paraqes Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë. Sipas këtij paragrafi, Prokurori Publik, i pandehuri dhe avokati mbrojtës mund të paraqesin Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë.
- **Paragrafi 2 – në mënyrë specifike lidhet me Prokurorin Publik.** Ky paragraf përcakton se Prokurori Publik mund të paraqes Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë në dobi apo në dëm të të pandehurit.
- **Paragrafi 3 – mënyrë specifike lidhet me avokatin mbrojtës dhe “personat e tjerë”.** Ky paragraf përcakton se avokati mbrojtës dhe “personat e tjerë” mund të paraqesin Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë brenda afatit prej tre muajve.

Çështja në analizë është fushëveprimi i “personave të tjerë” të paragrafit 3, në veçanti, nëse Prokurori Publik është i përfshirë dhe nëse është i obliguar që ta respektoj afatin prej tre muajve për të paraqitur Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë.

Lidhur me këtë, neni 452 paragrafi 3 përcakton se “*personat e tjerë*” janë ata persona “*të përmendur në fjalinë përfundimtare të nenit 443 paragrafit 1 të këtij kodi*”. Në këtë kuptim, fjalia përfundimtare e nenit 443 paragrafi 1 përcakton “*Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori publik, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, farefisi në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit.*”

Në mënyrë që të interpretohet drejtë neni 452 paragrafi 3, ne patjetër duhet ta lexojmë atë në lidhje me nenet ligjore paraprile të tij. Ky nen bazohet në nenin 416 të Kodit të Procedurës Penale të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPKRSFJ-së): “*Prokurori Publik kompetent mund të paraqes kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë kundër vendimeve efektive të gjykatës dhe kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë atyre vendimeve efektive nëse është shkelur ligji*”. Sipas legjislacionit të mëhershëm mjeti për Mbrojtjen e Ligjshmërisë mund të paraqitet **vetëm** nga Prokurori Publik dhe **pa asnjë afat**. Asnjë palë tjetër përveç Prokurorit Publik nuk ka qasje në këtë mjet juridik.

Qëllimi i qartë i Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës është që të përcaktojë një procedurë penale më pjesëmarrëse dhe t’i ofroj qasje në mjetin për Mbrojtjen e Ligjshmërisë të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe “*personave të tjerë*” me një afat prej tre muajve; kur neni 452.3 i referohet “*personave të tjerë*” nuk është duke iu referuar Prokurorit Publik por “*bashkëshortit, bashkëshortit*

jashtëmartesor, farefisit në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindit adoptues, fëmijës së adoptuar, vëllait, motrës ose prindit birësues të të dënuarit.” Prokurori Publik në mënyrë specifike është i rregulluar në paragrafin 2 të nenit 452 sipas kriterit të ligjit paraprirës për të cilin nuk ka afat.

”

Nuk mund të jetë ndryshe. Prokurori Publik nuk mund të përfshihet në kategorinë e *“personave të tjerë”* dhe të rregullohet vetëm me referimin në një nen tjetër. Nëse qëllimi i ligjit ka qenë për ta ndryshuar kriterin paraprirës dhe të përcaktoj afatin prej tre muajve për Prokurorin Publik, kjo do të ishte bërë në paragrafin 2 të nenit 452 i cili në mënyrë specifike lidhet me Prokurorin Publik.

Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme tanimë e ka adresuar këtë çështje në aktgjykimin e saj Pkl – Kzz 119/2010, të datës 20 janar 2010; në kuptim të njëjtë, Gjykata Supreme tanimë ka konstatuar se Prokurori Publik nuk përfshihet në kategorinë e *“personave të tjerë”* të referuar nga neni 452 paragrafi 3 i KPPK-së dhe, prandaj, nuk obligohet me afatin prej tre muajve për të paraqitur mjetin për Mbrojtjen e Ligjshmërisë.

Sidoqoftë, neni 452 i KPPK-së duhet të lexohet në lidhje me dispozitat e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drehtave Themelore dhe Lirive të Njeriut (KEDNj) e cila është në mënyrë të drejtpërdrejtë e aplikueshme në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës. Në veçanti, neni 452 i KPPK-së duhet të interpretohet në dritën e nenit 6 të KEDNj-së i cili përcakton të Drejtën për një Gjykim të Drejtë.

Gjykata Supreme nuk e ndan mendimin e Prokurorit Publik sipas të cilit mjeti për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk duhet t’i nënshtrohet *“kohës së arsyeshme”* të garantuar me nenin 6 të KEDNj-së duke pasur parasysh se nuk ka asnjë ndikim në të drejtat individuale dhe se ka vetëm efekt deklarativ nga i cili sistemi ligjor do të ketë dobi.

Gjykata Supreme konsideron se mjeti për Mbrojtjen e Ligjshmërisë mund të ketë ndikim të qartë dhe konkret në të drejtat individuale, për shembull në lidhje me përgjegjësinë civile e cila rrjedh nga aktivitetet kriminale; pasojat civile të një vepre penale janë çështje të një rëndësie kapitale të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë prekin të drejtat individuale dhe duhet të përcaktohen brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 6 KEDNj-së.

Në lidhje me këtë, jurisprudenca e KEDNj-së përcakton konceptin e *“kohës së arsyeshme”* si në vijim:

LËNDA KRASUSKI kundër POLONISË

(Kërkesë nr. 61444/00)

AKTGJYKIM

STRASBURG

14 qershor 2005

“55. Gjykata do të shqyrtojë arsyeshmërinë e asaj periudhe në frymën e rrethanave të lëndës dhe duke iu referuar kritereve të përcaktuara me praktikën e saj gjyqësore, në veçanti të natyrës komplekse të lëndës, sjelljes së parashtruesit dhe të organeve përkatëse si dhe objektit të parashtruesit në atë kontest (shih, mes shumë autoriteteve të tjera, Frydlander kundër Francës [GC], nr. 30979/96, § 43, GjEDNj 2000-VII, dhe Humen kundër Polonisë [GC], nr. 26614/95, § 60, 15 tetor 1999).”

Thënë shkurt, Neni 452 i KPPK-së duhet të lexohet në kuptimin e Nenit 6 të KEDNj-së, që do të thotë se **gjatë ushtrimit të mjetit juridik të Mbrojtjes së Ligjshmërisë, Prokurori Publik nuk është i detyruar që ta respektojë afatin kohor prej tre muajsh të përcaktuar me Nenin 452.3 KPPK-së por duhet patjetër që ta respektojë kufizimin e përgjithshëm të “kohës së arsyeshme” të përcaktuar me Nenin 6 të KEDNj-së, të interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut.**

2.2. Opsionet procedurale në shkallën e dytë kur aktgjykimi i shkallës së parë përmban vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike

Aktgjykimi i shkallës së dytë Ap-Kz Nr. 1/2009 i datës 7 tetor i nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës bën vlerësimin e opsioneve procedurale në funksion të adresimit të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike të aktgjykimit të shkallës së parë; në faqen 18 të versionit anglisht thuhet *“Si pasojë e kësaj Aktgjykimi sipas Nenit 385, par. 1 të LPP-së – KPP-së të RSFJ-së – duhet të prishet dhe lënda të prapësohet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Formulimi i ligjit procedural ashiqare nuk parasheh ndonjë mjet tjetër juridik. Në veçanti nuk lejon ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë”.*

Gjykata Supreme pajtohet me Prokurorin Publik se analiza është bërë gabimisht. Një lexim i thjeshtë i Ligjit të procedurës penale tregon opsionet e tjera procedurale: Neni 381.1 të KPP të RSFJ-së *“Në seancën e kolegjit ose në bazë të shqyrtimit, gjykata e shkallës së dytë (...) rishqyrton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë”*; Neni 372 *“1- Gjykata e shkallës së dytë sjell vendimin në seancën e kolegjit ose në bazë të shqyrtimit të mbajtur. 2- Gjykata e shkallës së dytë vendos në seancën e*

kolegjit nëse duhet apo jo të mbajë shqyrtimin.”

Me qëllim të sqarimit të çështjes së **RIGJYKIMEVE** dhe të harmonizimit të praktikave të shkallës së dytë në Kosovë, në paragrafët e ardhshëm Gjykata Supreme do të analizojë opsionet procedurale për gjykatën e shkallës së dytë në rast të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, edhe sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPP të RSFJ-së) edhe sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së):

Si parim që do të ndiqet në të gjitha ankesat kundër aktgjykimeve të shkallës së parë, sipas gjykatës së shkallës së dytë, kur faktet nuk janë vërtetuar në mënyrë të qartë dhe korrekte, gjykata ka këto opsione procedurale:

- 1) Të bëjë vlerësimin e ri të provave në dispozicion në shkresat e lëndës dhe të përcaktojë faktet në mënyrë të qartë dhe korrekte në aktgjykimin e shkallës së dytë (Nenet 424.4, 426.1 të KPPK-së / Neni 381.1 në formë të gjobës KPP i RSFJ-së).
- 2) Të caktojë shqyrtimin në shkallën e dytë me qëllim të vërtetimit të fakteve (Nenet 411 dhe 413.4 të KPPK-së / Nenet 372 dhe 373.1 KPP i RSFJ-së).
- 3) Të kthejë lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, duke pasur parasysh se ky opsion duhet të përdoret vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur nuk ka mundësi që të vërtetohen faktet në shkallën e dytë sipas paragrafit një dhe dy më lart (Neni 424.1 në formë të gjobës KPPK / Neni 385.1 KPP i RSFJ-së).
- 4) Të shfajësojë të pandehurin në bazë të mungesës së provave të mjaftueshme për mbështetjen e akuzave, duke pasur parasysh se ky opsion duhet patjetër të ushtrohet kur nuk është e mundur të bëhet vërtetimi i fakteve sipas paragrafëve një, dy ose tre më sipër (Neni 420.4 në kuptim të Nenit 390.3 të KPPK-së / Neni 381.1 në formë të gjobës, në kuptim të Nenit 350.3 të KPP të RSFJ-së).

Praktika në gjykatat e shkallës së dytë që në mënyrë sistematike t'i kthejnë lëndët për rigjykim në shkallën e parë rezulton në krijimin e pengesave për të gjitha palët dhe pengesa për sistemin të cilat e shndërrojnë sistemin e zbatimit të drejtësisë në një sistem seriozisht jofunksional – siç e kemi parë në rastin e kësaj lënde e cila paraqet një shembull të qartë – prandaj, kjo praktikë duhet që të korrigjohet. Kthimi i lëndës për rigjykim kurrë nuk duhet të shërbejë si rregull por vetëm si përjashtim. Është ky një lloj vendimi i cili duhet patjetër të shqyrtohet me kujdes të posaçëm nga ana e gjykatave të shkallës së dytë dhe i njëjti mund të miratohet VETËM në rrethana të jashtëzakonshme.

2.3. A ishte lirimi i të pandehurit në përputhje me ligjin.

Aktgjykimi i shkallës së dytë Ap-Kz Nr. 1/2009 i datës 7 tetor i lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës liron të pandehurin nga të gjitha akuzat. Gjykata e shkallës së dytë argumenton se Neni 385.1 i LPP-së obligon të priset aktgjykimi i shkallës së parë dhe të kthehet lënda për rigjykim dhe ligji nuk ofron asnjë mjet tjetër, e në veçanti, nuk lejon të ndryshohen aktgjykimet e shkallës së parë. Sipas gjykatës së shkallës së dytë, Neni 385.1 i LPP-së duhet të interpretohet në frymën e KEDNJ-së, posaçërisht Neni 6 i cili thotë se secili i pandehur ka të drejtë të ketë procedurë penale “*brenda një kohe të arsyeshme*”. Gjykata e shkallës së dytë argumenton se i pandehuri është gjykuar jo më pak se tri (3) herë në nivel të shkallës së parë dhe jo më pak se tri (3) herë në nivel të shkallës së dytë dhe nënvizon se procedura penale kishte filluar në vitin 1999; lidhur me këtë, numri i rigjytimeve në kombinim me kalimin e dhjetë vjetëve shënon një vonesë të patolerueshme të procedurës dhe rrjedhimisht kërkon që procedura penale kundër të akuzuarit të ndërpritet me qëllim që të mbrohen të drejtat e tij themelore njerëzore. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së dytë është përmbajtur që të kthejë lëndën për një tjetër rigjykim dhe, në vend të kësaj, zbatoi parimin *in dubio pro reo*, ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë në tërësi dhe e liroi të akuzuarin nga të gjitha akuzat.

Gjykata Supreme pajtohet me Prokurorin Publik se ka shkelje esenciale të dispozitave të Procedurës Penale në këtë arsyetim të aktgjykimit të shkallës së dytë Ap-Kz Nr. 1/2009 të datës 7 tetor dhe prandaj duhet të korrigjohet.

Së pari, Neni 385.1 i KPPRSFJ-së nuk është vetmi opsion procedural për gjykatën e shkallës së dytë kur aktgjykimi i shkallës së parë përmban vërtetim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike; siç është treguar më lart, gjykata e shkallës së dytë ka mundur të bëjë një vlerësim të ri të provave në përputhje me Nenin 381.1 *in fine* KPPRSFJ ose ka mundur të caktojë një shqyrtim në nivel të shkallës së dytë për të vërtetuar drejt faktet në përputhje me Nenet 372.2 dhe 373.1 të KPPRSFJ-së. Në fakt, gjykata e shkallës së dytë ka mundur të bëjë një vlerësim të ri të provave ose të mbajë një shqyrtim tjetër secilën herë që kjo lëndë është gjykuar në nivel të shkallës së dytë gjatë dhjetë (10) vjetëve precedent në vend të kthimit të lëndës në shkallë të parë për rigjykim duke provokuar një vonesë të padurueshme në zbatimin e drejtësisë.

Më tutje, as interpretimi i Nenit 6 i KEDNJ-së nuk është i drejtë. Aktgjykimi i shkallës së dytë vetëm merr parasysh kohëzgjatjen totale të procedurës që prej fillimit më 1999 (10 vjet në kohën e aktgjykimit). Sipas jurisprudencës së KEDNJ-së kohëzgjatja e arsyeshme e procedurës duhet të

vlerësohet duke u bazuar në rrethanat e lëndës; çdo periudhë e mos-aktivitetit duhet të vlerësohet drejt dhe duhet të konstatohet se a i ngarkohet të pandehurit apo jo; natyra komplekse e lëndës dhe provat po ashtu duhet të merren parasysh. Në këtë kuptim:

LËNDA STRAËIN DHE TË TJERËT kundër RUMANISË
(Kërkesë nr. 57001/00) AKTGJYKIM
STRASBOURG
21 korrik 2005

Gjykata përsërit se arsyeshmëria e zgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në frymën e rrethanave të lëndës dhe duke iu referuar kritereve të përcaktuara me praktikën e vet gjyqësore, në veçanti të natyrës komplekse të lëndës, sjelljes së parashtruesit të kërkesës dhe organeve përkatëse dhe objektit të parashtruesit të kërkesës në kontest (shih, në mes shumë autoriteteve tjera, Frydlender v. Francës [GC], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII, dhe Hartman v. Republikës Çeke, nr. 5334199, § 73, 10 korrik 2003).

Përveç kësaj, Gjykata e shkallës së dytë e ka prishur aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka aplikuar parimin *in dubio pro reo* si bazë ligjore për të liruar të pandehurin nga të gjitha akuzat. Duke e bërë këtë, aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së dytë e lë lëndën **jo të gjykuar, e cila përbën dështim të sistemit gjyqësorë**. Në fakt, parimi *in dubio pro reo* mundet vetëm të zbatohet pas shterjes së të gjitha fuqive sipas detyrës zyrtare të ofruara për gjyqtarët nga Ligji me qëllim të vërtetimit të fakteve. Nëse Gjykata e shkallës së dytë ka konsideruar që provat në dispozicion në shkresat e lëndës pas tri gjykimeve nuk ishte e mjaftueshme për të dënuar të pandehurin, do të duhej të liroj të pandehurin në bazë të mungesës së provave të mjaftueshme për përkrahjen e akuzave. Janë bërë përpjekje të rëndësishme në nivel të shkallës së parë me qëllim të vërtetimit të fakteve sipas udhëzimeve të Gjykatës së shkallës së dytë (p.sh. rigjykimi i parë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë ka mbajtur dyzet e katër -44- seanca). Gjykata e shkallës së dytë nuk do të duhej të mos përfill procedurën e tërësishme dhe të liroj të pandehurin në bazë të parimit *in dubio pro reo*. Nëse shkalla e dytë ka konsideruar që provat nuk janë të mjaftueshme për të dënuar të pandehurin, do të duhej në mënyrë të rregull të gjykoj lëndën dhe të liroj të pandehurin në bazë të mungesës së provave në përkrahje të akuzave.

Në këtë kuptim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vërteton nevojën që kurrë mos të lihet e padënuar kërcënimet ndaj jetës me qëllim të ruajtjes së besimit të publikut të përgjithshëm në administrimin e drejtësisë.

AFFAIRE ALIKAJ ET AUTRES c. ITALIE

(Requête n° 47357/08)

ARRÊT

STRASBOURG

29 mars 2011

“94. (...) Juridiksionet kombëtare kurrë nuk mund të lënë pa ndëshkuar kërcënimet ndaj jetës. Kjo është e nevojshme me qëllim të ruajtjes së besimit të publikut të përgjithshëm dhe për të siguruar përputhjen e saj me sundimin e ligjit dhe gjithashtu që të parandalohet çfarëdo paraqitje që shteti do të mund të toleroj veprime ilegale që do të ndeshen me kryerjen e tyre (...)

107. Gjykata gjithashtu vëren se 11 vjet pas vdekjes së Julian Alikaj, Gjykata Supreme, pasi që ka pranuar se A.R është fajtor i “vrasjes nga pakujdesia” ka shpallur “të ndërprerë” sepse elementet përbërëse të veprës janë parashkruar.

108. Gjykata vëren se hapat e ndërmarrë nga autoritetet hetuese pas vdekjes së Julian Alikaj dhe nga gjyqtarët gjatë gjykimit nuk janë të diskutueshme. Megjithatë, duke marr parasysh obligimin e përpikërisë dhe të kujdesit të arsyeshëm, të cilët janë të padyshimtë sa i përket obligimeve pozitive në fjalë, është e mjaftueshme të vëzhgohet që zbatueshmëria e parashkrimit i përket kategorisë së masave të papranueshme, sipas jurisprudencës së Gjykatës, sepse ky zbatim ka pasur si pasojë parandalimin e dënimit.(...)

111. Prandaj, Gjykata konsideron se larg nga të qenit rigoroz të sistemit penal siç zbatohet këtu nuk ka qenë mjaft e fortë për të parandaluar në mënyrë efikase veprat joligjore siç janë raportuar nga paditësit. Në rrethanat e veçanta të kësaj lënde, Gjykata arrin në përfundim se kjo procedurë penale nuk ka ofruar rivendosje të duhur sa i përket shkeljes së nenit 2 të Konventës.”

Përfundimisht, aprovohet kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë e ushtruar nga Prokurori Publik kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 1/2009.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Më 15 prill 2011, Pkl.-Kzz. nr. 62/2010

Kryetarja e kolegjit:

Maria Giuliana Civinini

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtarë të kolegjit:

Charles L. Smith III
Gjyqtar i EULEX-it

Lars Dahlstedt
Gjyqtar i EULEX-it

Salih Toplica
Gjyqtar i GjS-së

Marie Ademi
Gjyqtare e GjS-së